

z. Nexhmi Rexhepi

Kryetar

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Prishtinë, 12 gusht 2026

Kërkesë për ndërmarrjen e veprimeve sipas detyrës zyrtare (ex officio) për moszbatimin e Aktgjykimit KO124/25

I nderuar Kryetar z. Rexhepi,

Ne, organizatat e shoqërisë civile, nënshkruese të kësaj kërkesë, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit lidhur me konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve të 7 qershorit 2026, ju drejtohem me kërkesë që Gjykata Kushtetuese, ex-officio, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të Aktgjykimit KO124/25.

Sipas rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të certifikuara më 8 korrik 2026, afati 30-ditor për konstituimin e Kuvendit, në kuptim të nenit 66 të Kushtetutës dhe Aktgjykimit KO124/25, ka përfunduar më 7 gusht 2026.

Rikujtojmë se në paragrafët 131, 132, 133, 139, 140 dhe 145 të Aktgjykimit KO124/25, Gjykata ka përcaktuar se: (i) afati prej 30 ditësh për konstituimin e Kuvendit është detyrim kushtetues dhe jo afat orientues; (ii) se brenda këtij afati duhet të përmbushen të gjitha veprimet kushtetuese që rezultojnë në konstituimin e Kuvendit; (iii) se një seancë e cila nuk përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkyetarëve nuk prodhon efektin juridik të konstituimit; (iv) se seanca konstituive është një seancë unike; dhe se (v) Kuvendi duhet të konstituohet me sukses brenda afatit 30-ditor.

Përkundër këtij përcaktimi të qartë të Gjykatës, më 6 gusht 2026 seanca konstituive e Kuvendit nuk është përfunduar me sukses. Pas kërkesës për shtyrjen e seancës, ajo është ndërprerë, ndërsa vazhdimi i saj është caktuar për 8 gusht 2026, pra pas skadimit të afatit 30-ditor.

Rrethanat aktuale, sipas vlerësimit tonë, paraqesin dyshim të bazuar për moszbatim të Aktgjykimit KO124/25. Moszbatimi i një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, prek autoritetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sigurinë juridike, funksionalitetin e institucioneve kushtetuese dhe sundimin e ligjit. Në këtë drejtim, rikujtojmë se Rregulli 60 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese përcakton mekanizmat për rastet e moszbatimit të vendimeve të Gjykatës, atë të nxjerrjes së Aktvendimit për Moszbatim dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit.

Për këto arsye, kërkojmë nga ju, si Kryetar i Gjykatës, që në pajtim me Rregullin 60 të Rregullores së Punës, të e procedoni këtë çështje për trajtim dhe të ndërmerrni veprimet e nevojshme, si institucion që shërben si gardian i kushtetutshmërisë, për vlerësimin e zbatimit të Aktgjykimit KO124/25.

Kërkojmë që Gjykata të vlerësojë nëse Aktgjykimi KO124/25 është zbatuar në tërësi dhe brenda afatit të përcaktuar prej 30 ditësh dhe, nëse konstaton se ai nuk është zbatuar, të nxjerrë Aktvendimin për Moszbatim, në pajtim me Rregullin 60 të Rregullores së Punës. Po ashtu, kërkojmë që, në rast të konstatimit të moszbatimit, Gjykata të njoftojë menjëherë Kryeprokurorin e Shtetit dhe t'ia përcjellë

çështjen për ndërmarrjen e veprimeve ligjore brenda kompetencës së Prokurorisë, përfshirë vlerësimin e përgjegjësisë për moszbatimin e një vendimi detyrues të Gjykatës Kushtetuese.

Kërkojmë gjithashtu që Gjykata, në kuadër të mekanizmave të përcaktuar në Rregullin 60, të ndërmarrë çdo veprim tjetër që e konsideron të nevojshëm për të garantuar zbatimin e plotë dhe efektiv të Aktgjykimit KO124/25.

Me respekt,

Organizatat e Shoqërisë Civile nënshkruese

1. Rrjeti i OJQ-ve AVONET
2. KMDL NJ
3. Shl Kosova
4. Advocacy Center for Democratic Culture - ACDC
5. CCNO
6. OJQ Pishtaret
7. Organizata Kosova - Women 4 Women
8. LDA Kosova
9. Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqerore - CSGD
10. Instituti për Studime Evropiane Globale - ISEG
11. Instituti për Politika Sociale, Promovim dhe Mbrojtëjen të të Drejtave të Njeriut - IPSDMNJ
12. OJQ Akademia
13. OJQ Pontis
14. OJQ VLD